

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

## RAPORT VJETOR

- *Veprimtaria mësimore, kërkimore-shkencore për vitin akademik 2016-2017*
- *Veprimtaria financiare për vitin 2017*

*Tiranë, shkurt 2018*



## Përmbajtje

Hyrje.....	3
1. Veprimtaria e organeve drejtuese në UMT.....	4
2. Veprimtaria mësimore për vitin akademik 2016-2017.....	6
2.a) Programet e studimit që ofrohen në njësité kryesore të UMT-së.....	6
2.b) Personeli akademik dhe ndihmës akademik .....	11
2.c) Studentët .....	11
2.d) Infrastruktura.....	12
3. Veprimtaria shkencore për vitin akademik 2016-2017.....	12
3.a) Aktivitete shkencore që janë zhvilluar nga njësité kryesore të UMT.....	12
3.b) Kualifikimi Shkencor .....	17
3.c) Veprimtaria shkencore botuese. ....	17
3.d) Pjesëmarrja në projekte .....	17
4. Veprimtaria Financiare 2017 .....	23
4.a) Shpenzime Korente.....	23
4.b) Realizimi i të Ardhurave .....	28

## Hyrje

Themelimi i Institutit të Lartë Mjekësor (ILM) daton në 22 shtator të vitit 1952 dhe detyra e këtij institucioni ishte të përgatiste vetëm *Mjekë të Përgjithshëm*.

**Në vitin 1957** u vendos krijimi i Universitetit të Tiranës, mbi bazën e disa instituteve të larta, ku përfshihej dhe Instituti i Lartë Mjekësor, i cili u shndërrua në **Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës**.

Në vitin 1994 u themelua Shkolla e Lartë e Infermierisë. Pas një dekade veprimtarie, në vitin 2004, kjo shkollë u shndërrua në **Fakultetin e Infermierisë**, në varësi të **Universitetit Shtetëror të Tiranës**.

Vitet e fundit u shoqëruan me ndryshime radikale të sistemit ekonomik dhe social, të cilat u pasqyruan drejtpërdrejt edhe në Fakultetin e Mjekësisë dhe në Fakultetin e Infermierisë, të cilët u drejtuan përfundimisht drejt praktikave dhe përvojave perëndimore.

**Universiteti i Mjekësisë, Tiranë**, u krijua në vitin 2013. Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike u shkëputën nga Universiteti i Tiranës, duke u përfshirë në njësitë kryesore të UMT-së. Në vitin 2013, UMT përbëhej nga pesë fakultete:

Fakulteti i Mjekësisë,  
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike,  
Fakulteti i Mjekësisë Dentare,  
Fakulteti i Farmacisë,  
Fakulteti i Shëndetit Publik.

Pas riorganizimit institucional në vitin 2016, **Universiteti i Mjekësisë, Tiranë**, aktualisht përbëhet nga tre fakultete:

1. **Fakulteti i Mjekësisë,**
2. **Fakulteti i Mjekësisë Dentare,**
3. **Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike.**

**Raporti vjetor lidhur me veprimtarinë mësimore, kërkimore-shkencore për vitin akademik 2016-2017 dhe për veprimtarinë financiare për vitin 2017, përputhet me kërkesat e**

- Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor të institucioneve të arsimit të lartë në RSH”,
- Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,
- Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,
- Planit të zhvillimit strategjik të UMT-së,
- Raportet/analizat vjetore të njësive kryesore të UMT-së, përkatësisht:

- Raportin Vjetor mësimit, kërkimor e shkencor dhe financiar të Fakultetit të Mjekësisë (shkresë Nr.2502/1 Prot., datë 20.02.2018),
- Raportin Vjetor mësimit, kërkimor e shkencor dhe financiar të Fakultetit të Mjekësisë Dentare (shkresë Nr.562/5 Prot., datë 28.02.2018),
- Raportin Vjetor mësimit, kërkimor e shkencor dhe financiar të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike (shkresë Nr.191 Prot., datë 22.02.2018).

Ky raporti bazohet edhe në analizat e pasqyruara nga organet kolegjiale në UMT (Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Këshilli i Etikës, Këshilli i Botimeve, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë) dhe njëkohësisht nga anketime të zhvilluara në këtë institucion.

## 1. Veprimtaria e organeve drejtuese në UMT

**Senati akademik (SA)** i UMT-së është organi më i lartë kolegjial drejtues, i cili merr vendime mbi terësinë e veprimeve, masave apo detyrave, të cilat parashikojnë ecurinë dhe zhvillimin institucional në fushën e aktivitetit akademik mësimit, kërkimit shkencor dhe organizimit administrativ dhe financiar.

Në cilësinë e organit më të lartë vendimmarrës, Senati Akademik i UMT-së për vitin akademik 2016-2017 ka marrë vendime (79 vendime), kryesisht lidhur me:

- Miratimin e akteve/dokumenteve që parashikojnë funksionimin e duhur dhe zhvillimin e Universitetit të Mjekësisë Tiranë si: Strategjia e zhvillimit të UMT-së 2017-2020; Rregulloren e Specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë për vitin akademik 2016-2017,
- Miratimin e programeve të studimit në kuadër të hapjes së tyre; Ndryshime në planet mësimore të programeve ekzistuese që ofron UMT-ëja; Miratimin e riorganizimit të programeve të ciklit të dytë “Master Profesional”, bazuar në ligjin e ri të arsimit të lartë; Miratimin e pedagogëve me kontratë dhe të ftuar që janë angazhuar në vitin akademik 2016-2017; Miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimeve për vitin akademik 2016-2017 në të gjitha ciklet e studimit që ofron UMT-ëja.
- Miratimin e Strukturës dhe numrit të punonjësve të UMT-së për vitin 2017; Projekt Buxhetit të UMT-së 2017; Tarifave të shkollimit të studentëve për vitin akademik 2016-2017; Kriteret për përjashtimin nga tarifa e shkollimit të studentëve që i përkasin kategorive të veçanta.
- Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit sikundër edhe dhe institucione të tjerë.

Miratimin e dhënies së titullit *Doctor Honoris Causa* për Dr. Vittorio Vanini, Dr. Alva B. Weir. Këto vendime apo vendimmarrje të tjera të Senatit Akademik të UMT-së në mbledhjet përkatëse, dëshmojnë efikasitetin dhe efektivitetin e këtij organi kolegjial.

**Bordi i Administrimit (BA)** është organi më i lartë kolegjial administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

**Këshilli i Etikës [KE]** i UMT-së është organ kolegjal, i cili mbikëqyr zbatimin e normave të sjelljes dhe të moralit në mjedisin e UMT-së. Në rast moszbatimi të këtyre normave Këshilli i Etikës e sjell çështjen në vëmendjen e titullarit institucional i cili vepron sipas procedurave përkatëse institucionale. Ky këshill trajton çështje që kanë të bëjnë kryesisht me moszbatimin e Kodit të Etikës në marrëdhënien mes studentëve dhe stafit akademik dhe njëkohësisht shqyrton ankesat që mund të paraqiten për thyerjen e Kodit të Etikës, gjatë aktiviteteve të ndryshme që zhvillohen në UMT.

KE-ja , në përputhje me Kodin e Etikës dhe Rregulloren në fuqi, ka identifikuar një rast të thyerjes së Kodit të Etikës në vitin akademik 2016-2017.

KE-ja ka shprehur qëndrimin e saj lidhur me këtë rast dhe ka zbatuar procedurën përkatëse për zgjidhjen e këtij të fundit.

**Këshilli i Botimeve [KB]** i UMT-ësë është organ kolegjal i cili shqyrton tekstet mësimore për studentët, për ciklin e tretë të studimeve dhe për edukimin në vazhdim të profesionistëve në fushat e mjekësisë. Ky organ shqyrton dhe përkthimet e teksteve të ndryshme mësimore, ribotimin e tyre dhe është përgjegjës për miratimin ose mosmiratimin e tyre. Këshilli i Botimeve ushtron veprimtarinë e tij mbi bazën e Rregullores së Botimeve Mësimore Shkencore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

Gjatë vitit akademik 2016-2017, Këshilli i Botimeve ka organizuar katër mbledhje, në të cilat, u miratua e publikimi i teksteve të mëposhtëm:

1. “Manual anestezie” Prof. Hektor Sula, Prof. asc. Ilir Ohri, Rudin Domi.
2. “Damage control surgery” Dr. Agron Dogjani.
3. “Kimia toksikologjike” Prof. Besnik Jucja, Dr. Linda Matua.
4. “Sindroma e ovarit polikistik” Prof. asc. Eliona Demaliaj.

Njëkohësisht, **KB-ëja** shqyrton dhe miraton të gjithë artikujt shkencorë që i përmbushin kriteret e botimit në buletin e shkencave mjekësore në nivel universiteti “*The Albanian Journal Of Medical and Health Sciences*” (informacion i detajuar gjendet ne pikën 3. c) te këtij raporti).

**Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [NJSBC]** është njësia që vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore në përputhje me standardet e cilësisë. NJSBC vepron duke u bazuar në Rregulloren e saj dhe në Manualin e Cilësisë të hartuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Në vitin akademik 2016-2017 u zhvillua procesi i vlerësimit dhe akreditimit institucional të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Në këtë proces 4 anëtarë të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, ishin anëtarë të NJSBC-ësë.

**Rektorati, dekanatet, dhe strukturat përgjegjëse administrative** në rektorat, kryejnë detyrat përkatëse të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e UMT-së, apo në aktet rregullatore specifike për to; Zbatojnë procedurat që vijnë vendimet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, veprimtarinë akademike të stafit, specifike për to apo të organeve të tjera kolegjiale të sipërshënuar.

UMT-ëja nxit sistematikisht pjesëmarrjen e studentëve dhe të stafit akademik në projekte të ndryshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Sektori i Komunikimit në UMT publikon të gjitha thirrjet që lidhen me projekte , bursa studimi dhe zhvillimin e konferencave në faqen zyrtare të UMT-së dhe profilit zyrtar të këtij institucioni në rrjetin social Facebook.

Në mjediset e UMT-së organizohen trajnime të ndryshme dhe ditë informuese mbi tema të caktuara të fushës së mjekësisë, të organizuara nga institucionet përkatëse për stafin akademik dhe studentët.

Lidhur me aktivitetet e lartpërmendura, organet kolegjiale akademike dhe administrative, Rektorati dhe dekanatet, njësitë bazë, si dhe njësitë administrative në nivel qendror dhe në nivel fakulteti, koordinojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Statutin e Rregulloren e UMT-së apo rregulloreve specifike dhe me legjislacionin në fuqi në përputhje me misionin e universitetit.

## 2. Veprimtaria mësimore për vitin akademik 2016-2017

### 2.a) Programet e studimit që ofrohen në njësitë kryesore të UMT-së

Në vitin akademik 2016-2017, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka ofruar programe në tre ciklet e studimit të pasqyruara në nivel fakulteti si më poshtë:

#### 1. FAKULTETI I MJEKËSISË

	CIKLI I STUDIMIT	PROGRAMI I STUDIMIT
1	Program i ciklit të parë të studimeve "Bachelor"	Shëndet publik
2	Program i ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional"	Shëndet publik
3	Program i ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional"	Menaxhim Shëndetësor
4	Program i ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave"	Shëndet publik
5	Program i Integruar i ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave"	Mjekësi e përgjithshme
6	Program i Integruar i ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave"	Farmaci
7	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Mjekësi urgjence
8	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Neurokirurgji
9	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Mjekësi interne
10	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Mjekësi transfuzive
11	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Alergologji
12	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Anatomi patologjike
13	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Anestezi-reanimacion
14	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Dermatologji
15	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Endokrinologji
16	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Gastrohepatologji
17	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Hematologji

18	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Diagnozë me imazhe
19	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Kardiokirurgji
20	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Kardiologji
21	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Kirurgji e përgjithshme
22	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Laborator klinik - biokimik
23	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Mikrobiologji
24	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Mjek familjeje
25	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Mjekësi ligjore
26	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Nefrologji
27	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Neurologji
28	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	ORL
29	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Obstetrikë - gjinekologji
30	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Okulistikë
31	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Onkologji
32	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Ortopedi - traumatologji
33	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Pediatri
34	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Pneumologji
35	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Psikiatri
36	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Psikiatri e fëmijëve dhe e adoleshentëve
37	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Reumatologji
38	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Sëmundje infektive
39	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Shëndet publik
40	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Toksikologji klinike
41	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Kirurgji Plastike, Rikonstruktive dhe Estetike
42	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime të Thelluara, në Farmakologji, Fiziologji, Fiziologji Patologjike
43	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve Infektive Emergjente dhe Riemergjente në Shqipëri
44	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shëndet Publik
45	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve të Lëkurës
46	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime të Thelluara dhe Kërkime në Otorinolaringologji
47	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime të Thelluara në

		Kardiologji
48	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime në Neuroshkencë
49	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime në Obstetrikë - Gjinekologji
50	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime në Mjekësi Laboratorike
51	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Morfologji Klinike
52	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Sëmundjet Kirurgjikale
53	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Imazheri
54	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Anatomi Patologjike dhe Mjekësi Ligjore
55	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Sëmundjet e Syrit
56	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Pediatri
57	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Sëmundjet e Brendshme
58	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shkencat Farmaceutike
59	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Kirurgji- Kardiokirurgji

Në vitin akademik 2016-2017 në Fakultetin e Mjekësisë u miratuan kuota pranimi për studentët, për programet e mëposhtëm:

- 1 program Bachelor
- 2 programe të integruara të ciklit të dytë
- 2 programe Master Profesional
- 1 program Master i Shkencave (120 kredite)
- 28 programe specializime afatgjata (nga 34 në total)

## 2. FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

	CIKLI I STUDIMIT	PROGRAMI I STUDIMIT
1	Program i ciklit të parë të studimit "Bachelor"	Infermieri e përgjithshme
2	Program i ciklit të parë të studimit "Bachelor"	Mami
3	Program i ciklit të parë të studimit "Bachelor"	Teknikë laborator
4	Program i ciklit të parë të studimit "Bachelor"	Logopedi
5	Program i ciklit të parë të studimit "Bachelor"	Teknikë imazherie
6	Program i ciklit të parë të studimit "Bachelor"	Fizioterapi
7	Program i studimit të ciklit të dytë "Master Profesional"	Menaxhim infermieror
8	Program i studimit të ciklit të dytë "Master Profesional"	Mami
9	Program i studimit të ciklit të dytë "Master Profesional"	Teknikë laborator
10	Program i studimit të ciklit të dytë "Master Profesional"	Logopedi
11	Program i studimit të ciklit të dytë "Master Profesional"	Fizioterapi
12	Program i studimit të ciklit të dytë "Master Profesional"	Teknikë imazherie
13	Program i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave"	Infermieri
14	Program i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave"	Teknikë laborator
15	Program i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave"	Logopedi



16	Program i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave"	Fizioterapi
17	Program i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave"	Teknikë Imazherie
18	Program i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave"	Mami
19	Program i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave"	Logopedi
20	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Lëndët Klinike
21	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Lëndët Paraklinike
22	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shkenca Infermierore me profil: Infermieri
23	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shkenca Infermierore me profil: Mami
24	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shkenca Infermierore me profil: Fizioterapi
25	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shkenca Infermierore me profil: Logopedi
26	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shkenca Infermierore me profil: Teknikë Laboratori
27	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Shkenca Infermierore me profil: Teknikë Imazherie

Në vitin akademik 2016-2017 në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike u miratuan kuota pranimi për studentët, për programet e mëposhtëm:

- 6 programe Bachelor
- 6 programe Master Profesional
- 6 programe Master i Shkencave

### 3. FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

	CIKLI I STUDIMIT	PROGRAMI I STUDIMIT
1	Program i integruar i ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave"	Stomatologji
2	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Kirurgji maksilo faciale
3	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Pedodonti
4	Program i ciklit të tretë të studimeve "Specializim Afatgjatë"	Terapi stomatologjike
5	Program i ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë"	Studime në patologji oro-makslo-faciale

Në vitin akademik 2016-2017 në Fakultetin e Mjekësisë Dentare u miratuan kuota pranimi për studentët për programet e mëposhtëm:

- 1 program i integruar i ciklit të dytë.
- 1 program specializim afatgjatë
- **Pranimet e reja për vitin akademik 2016-2017**

Në 9 programe të ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë, me kohë të plotë, nga 888 kuota të miratuara për kandidatët brenda territorit të vendit, u regjistruan 788 kandidatë të shpallur fitues në raundin e I+II dhe ngelën të paplotësuar 100 kuota nga të cilat: 14 kuota në Msc në Farmaci; 6 kuota në Msc Stomatologji dhe 80 kuota Bachelor në FSHMT).

Mosplotësimi i kuotave në UMT, erdhi për shkak të implementimit të procedurave të pranimit të maturantëve në institucionet e arsimit të lartë, në kontekst të ligjit të ri për arsimin e lartë (ligji nr.80/2015), i cili u shoqërua dhe me disa problematika.

Në programet e ciklit të dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave me kohë të plotë, nga 727 kuota të miratuara në nivel Universiteti, u plotësuan 699 kuota. Nga analiza e bërë lidhur me kuotat e paplotësuar (29) rezulton se programet e ciklit të dytë *Master Profesional* në “Logopedi” dhe Shëndet Publik, janë më pak të kërkuara.

Në programet e ciklit të tretë të studimeve Specializim Afatgjatë në fushën e mjekësisë, nga 186 kuota të miratuara, janë plotësuar 177 kuota. Duke u bazuar në pasqyruara nga njësitë kryesore totali i kuotave të paplotësuar është 9. Vlen për t’u theksuar fakti se numri total i aplikantëve për vitin akademik 2016-2017 ishte 315 kandidatë, të cilët plotësonin kriteret për aplikim<sup>1</sup>, dhe mosplotësimi i kuotave është për programe jo preferencialë nga ana e tyre.

- **Rishikimi i kurrikulave.**

Në vitin akademik 2016-2017, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, bazuar në ligjin e ri të arsimit të lartë, Statutin dhe Rregulloren e UMT-së, aktet nënligjore në fuqi, si dhe në propozimet e njërive kryesore, ka miratuar rishikimin e planeve mësimore të programeve të studimit që ofrohen në njësitë kryesore (fakultete) të UMT.

Në kuadër të ligjit për arsimin e lartë nr. 80/2015, u rishikua dhe miratua riorganizimi i programeve të ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” në Fakultetin e Mjekësore dhe Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike (programe ekzistuese me 90 ECTS; 1.5 vite akademike në programe me 60 ECTS; 1 vit akademik), në përputhje me kërkesat e ligjit.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë bazuar në planin e tij strategjik dhe në nevojat e tregut të punës të sektorit shëndetësor publik dhe privat, ka hartuar, miratuar dhe paraqitur pranë organeve përkatëse kërkesën për hapjen e programit të ri të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Kujdes Paliativ”. Aktualisht, pas kërkesës së MASR, mbi përmirësimin dhe plotësimin e dokumentacionit, ky program është në proces shqyrtimi nga ky institucion.

- **Edukimi në vazhdim**

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, bazuar në Nr. 440, datë 17.5.2017 “Për përcaktimin e standardeve, të kriterëve dhe procedurave të. Akreditimit të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në

---

<sup>1</sup> Referuar informacionit të marrë nga sekretaria mësimore e FM

vazhdim për profesionistët e shëndetësisë”, aplikoi për marrjen e statusit të ofruesit të akredituar, me qëllimin që: UMT të jetë qendër kyçe në promovimin dhe zhvillimin e edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetit duke theksuar objektivat kryesorë të kësaj strukture si më poshtë vijon:

- UMT përmes edukimit në vazhdim do mundësojë lehtësimin e fitimit të krediteve për strukturat e veta dhe ato mbështetëse;
- UMT përmes këtyre aktiviteteve do të rrisë të ardhurat e njësisë bazë dhe kryesore si dhe të vetë universitetit;
- Lidhjet dhe kontaktet me strukturat kombëtare dhe ndërkombëtare për ofrimin sa më cilësor të programeve të akredituara;
- UMT do të ofrojë edukimin në vazhdim pranë vendit të punës për specialistët e të gjitha fushave mjekësore brenda dhe jashtë Tiranës duke lehtësuar certifikimin e tyre.

Vlen për t’u theksuar se UMT ka infrastrukturën teknologjike, akademike dhe intelektuale si dhe i plotëson të gjitha standardet shtetërore të cilësisë për të realizuar aktivitetet e edukimit në vazhdim. Në nëntor të 2017, UMT-ëja ka marrë statusin e ofruesit të akredituar për aktivitetet e edukimit në vazhdim të profesionistëve të shëndetit.

## **2.b) Personeli akademik dhe ndihmës akademik <sup>2</sup>**

Në vitin akademik 2016-2017, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë janë angazhuar:

- 683 pedagogë, prej të cilëve 292 personel akademik me kohë të plotë dhe 391 personel akademik me kohë të pjesshme që vijnë nga strukturat shëndetësore universitare (SSHU) apo nga institucione të tjera.

Referuar titujve akademik dhe gradave shkencore të personelit akademik me kohë të plotë (292) në UMT, rezulton se 86% e personelit janë me tituj/gradë dhe 60% e tyre janë me tituj akademik (të shprehura në vlerë numerike përkatësisht: 100 pedagogë me titull “Profesor”, 72 pedagogë me titull “Profesor i Asociuar”, 79 pedagogë gradën shkencore “Doktor” dhe 41 pedagogë të kategorisë “Lektor”.

- 55 personel ndihmës akademik, nga të cilët 29 me kohë të plotë;
- 120 personel administrativ, nga të cilët 79 me kohë të plotë.

## **2.c) Studentët <sup>3</sup>**


Numri i studentëve që ndoqën studimet në vitin akademik 2016-2017 në programet e ciklit të parë të dytë dhe të tretë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, është 7454 studentë.

<sup>2</sup> Referuar te dhëna nga SBNJ në Rektorat

<sup>3</sup> Referuar raportit të njësisë kryesore

Shpërndarja e studentëve sipas njësive kryesore (fakulteteve) për vitin akademik 2016-2017, paraqitet si më poshtë (në formë tabelore dhe grafike):

Fakulteti	Bsc		MP		Msc		PICD		Doktoratë		Specializim Afatgjatë		Totali
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	
i Mjekësisë	26	0.72%	86	2.38%	51	1.41%	2625	72.61%	302	8.35%	525	14.52%	3615
i Shkencave Mjekësore Teknike	1806	57.74%	567	18.13%	586	18.73%	0		169	5.40%	0		3128
i Mjekësisë Dentare	0		0		0		668	93.95%	28	3.94%	15	2.11%	711
<b>Totali</b>	<b>1832</b>	<b>24.58%</b>	<b>653</b>	<b>8.76%</b>	<b>637</b>	<b>8.55%</b>	<b>3293</b>	<b>44.18%</b>	<b>499</b>	<b>6.69%</b>	<b>540</b>	<b>7.24%</b>	<b>7454</b>



Kalueshmëria e studentëve për vitin akademik 2016-2017, bazuar në të dhënat e Fakulteteve, rezulton nga 65%-75%, sipas ciklit të parë dhe të dytë të studimit. Informacioni më i detajuar gjendet te raportet vjetore te secilit fakultet.

## 2.d) Infrastruktura

UMT ka në dispozicion të procesit mësimor një sipërfaqe në total prej 77.698 m<sup>2</sup> ku përfshihen dhe ambientet e strukturave shëndetësore universitare (Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Klinika Universitare Stomatologjike, Spitali Universitar i Traumës, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik, “Mbretëresha Geraldinë”, Tiranë dhe Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik, “Koco Gliozheni”, Tiranë).

## 3. Veprimtaria shkencore për vitin akademik 2016-2017

### 3.a) Aktivitete shkencore që janë zhvilluar nga njësitë kryesore të UMT<sup>4</sup>

<sup>4</sup> Referuar raportit të njësive kryesore

Aktiviteti kërkimor shkencor është një ndër shtyllat kryesore, ku mbështetet plani strategjik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe është bazë për balancimin e dijeve teorike me ato praktike. Zhvillimi i aktivitetit të kërkimit shkencor vijon paralelisht me aktivitetin e mësimdhënies dhe së bashku janë motorët e mirëfilltë të zhvillimit dhe ecurisë së duhur institucionale. Në këtë kontekst, aktiviteti i kërkimit shkencor zhvillohet përmes konferencave shkencore në nivel universiteti dhe fakulteti, pjesëmarrjes në projektet e programeve Evropiane si Erasmus+ dhe Horizon2020, angazhimeve në grupet e punës kërkimore shkencore në fushat më të rëndësishme të studimeve mjekësore duke përfaqësuar Universitetin dhe vendin në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, hulumtimeve dhe publikimeve të artikujve shkencorë në Revistën shkencore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë “*Albanian Journal of Medical and Health Sciences (AJMHS)* (ISSN 2412-6373 dhe E-ISSN 2413-3892)” dhe Revistat shkencore të Fakulteteve: “Revista Stomatologjike Shqiptare” (organ i Fakultetit të Mjekësisë Dentare) dhe Revistën “Mjekësia Bashkëkohore” (organ i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike), si dhe përmes punës individuale shkencore të stafit akademik në departamente.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, gjatë vitit akademik 2016-2017 është angazhuar në drejtim të zhvillimit të aktiviteteve shkencore me synimin e vetëm për të promovuar punën kërkimore dhe dijet e reja nga stafi i tij akademik. Në kuadër të aktiviteteve të organizuara përfshihen kongreset, konferencat, simpoziumet me pjesëmarrje të profesionistëve të shëndetësisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Informacion më i detajuar për çdo fakultet, lidhur me aktivitetet shkencore për vitin akademik 2016-2017, pasqyrohet i detajuar si më poshtë vijon:

- **Fakulteti i Mjekësisë<sup>5</sup>**

Fakulteti i Mjekësisë ka organizuar kongrese dhe konferenca shkencore, si bashkëpunime mes Fakultetit të Mjekësisë dhe Shoqatave sipas Specialiteteve, me pjesëmarrje kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë vitit akademik 2016-2017, janë zhvilluar Konferenca, Forume, Leksione të hapura kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat janë organizuar në disa Shërbime/Seksione. Ato janë mbështetur nga Fakulteti i Mjekësisë dhe grupet organizatore janë mbështetur nga ana organizative dhe shkencore. Grupe pedagogësh kanë ndihmuar studentët duke siguruar cilësinë dhe vërtetësinë e të dhënave shkencore që janë paraqitur në këto aktivitete. të paraqitura. Në këto konferenca janë përfshirë disa studentë të Fakultetit të Mjekësisë, si pjesëmarrës e prezantues, përfshirë edhe ish-studentë të FM-ësë që aktualisht studiojnë dhe punojnë në vende të tjera. Fokusi kryesor ishte në specialitete si Kirurgji, Onkologji, Neurologji, Neurokirurgji, Alergologji, ORL etj, por kishte edhe referime në fushën e stomatologjisë, farmacisë dhe shëndetit publik.

Pjesa dërrmuese e pedagogëve të Fakultetit kanë marrë pjesë në evente shkencore (kongrese, konferenca, Workshop-e) nga më prestigjiozet në specialitetin e tyre.

Disa njësi të Fakultetit janë përfshirë në botime raportesh dhe broshurash në bashkëpunim me institucione dhe organizata vendase dhe të huaja si Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik, Organizata Botërore e Shëndetësisë etj.

- **Konferencat Shkencore Kombëtare të Fakultetit të Mjekësisë**

---

<sup>5</sup> Referuar raportit vjetor të Fakultetit të Mjekësisë

Titulli i konferencës/kongresit	Data e zhvillimit
Takim me përfaqësuesit e Agjencisë Universitare të Frankofonisë	14 Prill 2017
Kongresi Mjekësor i Fitnes dhe Nutricionit	28- 29 Prill 2017
Leksion mbi rolin dhe veprimtarinë e OBSH-së në Shqipëri	2017
Student për një ditë	22 Maj 2017
Leksione të hapura për Dietologji dhe Nutricion	2017
Amyotrophic Lateral Sclerosis: Innovative Clinical Approaches for present and the future	3 Qershor 2017
Workshop në shkencat mjekësore biologjike dhe komunikimin: Mjetet e reja të parandalimit dhe asistencë në sëmundjet kronike dhe neoplazike	14 Qershor 2017
Novel Antiepileptics and indications of Cannabinoids in resistant forms of epilepsi	2017

- **Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike<sup>6</sup>**

Gjatë vitit akademik 2016-2017, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike është angazhuar në mënyrë aktive në veprimtaritë shkencore, sipas një plani strategjik të miratuar në fillim të vitit akademik. Stafi akademik është angazhuar në aktivitete shkencore, ku përfshihen punime e referime shkencore, botime të teksteve mësimore, mbrojtje të titujve shkencorë.

- **Aktivitete shkencore**

Nr.	Titulli i konferencës/Workshop/leksione të hapur	Data e zhvillimit
1	WorkShop DLK: “Metodikat dhe mjetet e reja në standardizimin e praktikave infermiore”	21.01.2017
2	Konferenca mjekësore e personelit teknikien (FSHMT në bashkëpunim me Organizatën e teknikëve të imazherisë të Shqipërisë)	31.03.2017- 01.04.2017
3	Leksion i hapur DDRSHIKIOGJ: Tema “Terapia fizike, instrumentale në Fizioterapi midis të shkuarës dhe të ardhmes”.	25.03.2017- 24.04.2017
4	Leksion i hapur DDRSHIKIOGJ: Tema “Fizioterapia në neurorehabilitimin e hemiplegjisë”	03.05.2017
5	Leksion i hapur DDRSHIKIOGJ: Tema “Praktika radiologjike, kurrikula e Teknik Imazherie dhe procedurat e licencimit të këtyre teknikëve”	18.04.2017

- **Pjesëmarrje në aktivitete shkencore**

Nr.	Aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare	Numri
1	Pjesëmarrje në referim/poster në aktivitete shkencore	138

<sup>6</sup> Referuar raportit vjetor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike

	kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)	
